

KËRKESË PËR KUFIZIMIN E PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE PERSONALE

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.42/20, 294/21 dhe 101/25), Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale u mundëson subjekteve të të dhënave personale realizimin papengesë të të drejtës së tyre për kufizimin e përpunimit të të dhënave personale.

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale do të ndërmarrë të gjitha aktivitetet e nevojshme me qëllim për t'iu përgjigjur kërkesës së subjektit brenda 30 ditëve nga pranimi i kërkesës, përkatësisht nga marrja e informacionit shtesë nëse kërkesa e paraqitur fillimisht është e paqartë ose e paplotë.

1. Të dhëna për parashtuesin e Kërkesës

Emri dhe mbiemri	
Kategoria e subjektit (i/e punësuar, bashkëpunëtor/e i jashtëm, aplikant/e për punë, pjesëmarrës/e në aktivitete)	
Adresa	
Numri i telefonit për kontakt	
e-mail adresa	

2. Të dhëna për të cilat subjekti i të dhënave personale kërkon kufizim të përpunimit

Ju lutemi duke rrethuar shënoni arsyen pse po kërkon kufizim të përpunimit të të dhënave tuaja personale:

- Unë e kundërshtoj saktësinë e të dhënave personale.
- Përpunimi është i paligjshëm, prandaj në përputhje me këtë kërkoj kufizimin e përdorimit të tyre, por jo dhe fshirjen e tyre.
- Të dhënat personale më shumë nuk nevojiten për qëllimin fillestar, por nuk mund të fshihen sepse janë të nevojshme për vendosje (rivendosje), realizim ose mbrojtjen e kërkesa të mia juridike.
- Unë kërkoj verifikim që interesat legjitime të kontrolluesit mbizotërojnë mbi interesat e mia personale si subjekt i të dhënave personale.

3. Për cilat të dhëna personale kërkon kufizim të përpunimit?

Ju lutemi cekni për cilat të dhëna personale kërkon kufizim të përpunimit. Ju lutemi të na cekni të gjitha detajet përkatëse që do të na ndihmojnë të identifikojmë të dhënat personale për përpunimin e të cilave kërkon kufizim (numri i kontratës, data dhe mënyra e dhënies së pëlqimit, linku aktiv nëse kemi të bëjmë me të dhëna të shpallura publikisht, dhe të ngjajshme)

Në rastet kur përpunimi kufizohet në përputhje me bazat e përcaktuara në pikën 3, Agjencia për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale të dhëna të tilla personale mund t'i përpunojë vetëm me pëlqimin e subjektit të të dhënave, me përjashtim të ruajtjes së tyre ose për vendosjen, realizimin ose mbrojtjen e kërkesave të tij juridike

ose për mbrojtjen e të drejtave të një personi tjetër fizik ose juridik ose për arsye të rëndësishme me interes publik. Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale informon subjektin e të dhënave personale përpara se të ndërpritet kufizimi i përpunimit.

4. DEKLARATË

Unë, _____, konfirmoj se kam lexuar dhe kuptuar informacionin e përmbajtur në këtë Kërkesë dhe se informacioni që kam dhënë është i saktë. Unë kuptoj që Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale mund të kërkojë konfirmim të identitetit tim dhe/ose identitetit të subjektit të të dhënave personale, si dhe informacione shtesë që do të ndihmojnë në identifikimin e të dhënave për përpunimin e të cilit kërkoj kufizim.

Nënshkrimi

Data

Dokumentet bashkangjitur Kërkesës:

- Dëshmi për identitetin e subjektit të të dhënave personale (kur parashtruesi është person i autorizuar)
- Autorizim nga subjekti i të dhënave personale
- Arsyetim i Kërkesës (shpjegim i detajuar në përputhje me pikën 3)